



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



## **Shëndeti dhe Siguria në Punë në fabrikat e tekstileve dhe këpucëve në Shqipëri**



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Ky raport është përgatitur nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC) në kuadër të projektit rajonal “Sëmundjet profesionale të grave punonjëse të veshjeve në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut”, me mbështetjen financiare të Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme dhe Qeverisë së Suedisë. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme dhe Qeverisë së Suedisë.

### **Autorë**

Mirela Arqimandriti  
Keisi Gaxha

Raportin mund ta gjeni në [www.gadc.org.al](http://www.gadc.org.al)

### **Adresa:**

**Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”**

**Rr. “Abdyl Frasheri”, Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tirana, Albania**



## Table of contents

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>5</b>
<b>GJETJE KRYESORE.....</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>6</b>
<b>RËNDËSIA E MBROJTJES SË SHËNDETIT NË PUNË .....</b>	<b>8</b>
<b>KUADRI LIGJOR MBI SIGURINË E SHËNDETIN NË PUNË DHE ROLI I MJEKUT NË NDËRMARRJE .....</b>	<b>10</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>13</b>
<b>GJETJET KRYESORE DHE ANALIZA.....</b>	<b>13</b>
INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI GRUPIN E TARGETUAR .....	14
<b>KUSHTET HIGJIENIKE NË FABRIKA .....</b>	<b>16</b>
PËRDORIMI I PRODUKTEVE KIMIKE .....	17
MASAT MBROJTËSE .....	18
KËSHILLAT E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË –EKZISTENCA DHE ROLI I TYRE .....	20
MJEKU NË NDËRMARRJE – EKZISTENCA DHE ROLI.....	22
ÇËSHTJE SHQETËSUESE TË SHËNDETIT TË PUNONJËSVE.....	24
EKZAMINIMET E KRYERA NGA PUNËDHËNËSI.....	25
PERCEPTIMI MBI NIVELIN E SIGURISË NË PUNË .....	26
SHËNDETI, SIGURIA DHE INSPEKTORATI I PUNËS.....	27
<b>KONKLUZIONE .....</b>	<b>28</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>29</b>
<b>REFERENCA DHE BIBLIOGRAFI.....</b>	<b>31</b>



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



## Shkurtime

AL	Albania
KSSH	Këshilli i Sigurisë dhe Shëndetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
BE	Bashkimi Evropian
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
GT	Glacen Tekstilec
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ISHPSHS	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
SSHP	Siguria dhe Shëndeti në Punë
MK	Republika e Maqedonisë së Veriut



## Përmbledhje ekzekutive

Ky raport ofron një analizë të kornizës ligjore që rregullon çështjet e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. Gjithashtu analizon gjetjet nga vëzhgimi në terren me punonjëse të fabrikave të tekstileve e këpucëve. Më tej studimi jep disa rekomandime të rëndësishme në lidhje me çështje të shëndetit dhe sigurisë në punë, funksionimit të këshillave të sigurisë, mjekut në ndërmarrje etj. Gjetjet e hulumtimit do të përdoren për avokim dhe lobim me aktorët përkatës, në mënyrë që të nxisin veprime dhe të sigurohet që kjo temë të trajtohet më gjerë e të merren masa konkrete.

## Gjetje kryesore

Ky studim ka eksploruar disa dimensione në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e grave punëtore në fabrikat e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri. Disa gjetje kryesore janë më poshtë:

**Për shëndetin dhe sigurinë:** Gjetjet tregojnë se gratë besojnë se nuk kanë të drejtë të adresojnë shqetësimet e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, megjithëse shumica e grave punëtore punojnë në këmbë gjatë gjithë ditës dhe për këtë arsye vuajnë nga probleme shëndetësore ortopedike. Gjithashtu ato nuk janë në dijeni të kimikateve që përdorin gjatë procesit të punës apo punës në kushte të papërshtatshme pastërtie dhe higjienike. Nga ana tjetër, punëdhënësit nuk kanë dokumentacionin përkatës për vlerësimin e rrezikut të kimikateve që përdoren në pëlhurat e tyre.

**Për rolin e mjekut:** Hulumtimi tregon se mjekët nuk ndihmojnë shumë në mbështetjen e grave punëtore, pasi në të shumtën e rasteve mjekët nuk paraqiten ose edhe nëse janë të pranishëm nuk japin ndihmën e nevojshme. Është vlerësuar se mjekëve u mungon përgatitja për t'i ndihmuar këto gra në mënyrë profesionale. Ndërkohë që Këshillat e Shëndetit dhe Sigurisë janë fiktive dhe nuk ofrojnë asnjë lloj trajnimit apo presioni për përmirësuar kushtet e punës dhe trajtuar çështje të sigurisë dhe shëndetit.

**Për komunikimin me punëdhënësit:** Gjetjet tona tregojnë se ekziston nevoja për të krijuar një komunikim më të mirë midis grave dhe punëdhënësve të tyre, gjë që do të kishte një ndikim pozitiv edhe në shëndetin mendor të grave punëtore, duke pasur parasysh stresin e jashtëzakonshëm që ato përjetojnë për shkak të punës së palodhur, orëve të gjata në punë, problemeve shëndetësore dhe të ardhurave të ulëta. Kërkohet përmirësimi i kushteve të punës, si dhe rritja e pagave për të përballuar shpenzimet që lidhen edhe me shqetësimet shëndetësore.

**Për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH):** Hulumtimi ynë tregon se Inspektorati i Punës (IP) ka bërë një punë rigoroze në identifikimin e çështjeve problematike brenda fabrikave, duke kryer intervista me punonjësit për të marrë të dhënat e



vërteta mbi punën e tyre. Gratë punëtore deklarojnë se janë të njohura me Drejtorinë e Ankesave të IP, por megjithatë, kur inspektorët paraqiten për të ndjekur ankesën, gratë nuk janë bashkëpunuese me inspektorët e IP. Gratë punëtore nuk kanë besim ndaj tyre, megjithëse janë të vetëdijshme se inspektorët janë të detyruar me ligj të ruajnë anonimitetin në çdo rast.

## Hyrje

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë nëpërmjet të dhënave dhe analizave të mbledhura, kushtet e shëndetit dhe sigurisë së grave punonjëse të veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri, llojin e sëmundjeve profesionale që hasen, çfarë lloj kimikatesh përdoren në industri dhe efikasitetin e mjekut në ndërrmarrje. Metodologjia e përdorur e kërkimit për dokumentin e politikave konsiston në një metodë të përzier të të dhënave sasiore dhe cilësore. GADC hartoi dhe promovoi një pyetësor në mediat e saj sociale dhe zhvilloi gjithashtu intervista personale me punonjëse nga fabrikat e veshjeve dhe këpucëve. Pyetjet kishin si objektiv kryesisht tema si: paga, përdorimi i veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse, lloji i shqetësimit shëndetësor, lloji i kimikateve, ekzaminimet nga mjekët, etj. Gjithashtu, intervista u zhvilluan edhe me inspektorët e Inspektoratit të Punës.

Siguria dhe shëndeti në punë janë një çështje e rëndësishme në Bashkimin Evropian dhe duhet trajtuar po njësoj në të gjitha vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e tij, si Shqipëria. Shqyrtimi i çështjes në tërësi nga Këshilli dhe Komisioni Evropian konfirmon vendosmërinë e Bashkimit Evropian që nëpërmjet Direktivave të tij dhe përmes dialogut social të adresojë çështjet ekzistuese dhe të ardhshme në këtë fushë. Qëllimi është krijimi i një rruge inteligjente dhe proaktive drejt kulturës së parandalimit të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe pasojave që kanë drejtpërdrejt efekte shkatërruese financiare për vetë kompanitë apo për shtetin. Gjithashtu, aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë zhvillohet dhe adoptohet nën prizmin e dinjitetit në punë.

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) ka zbatuar për 5 vite radhazi projektin “Përmirësimi i kushteve të punës në sektorin e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri dhe fuqizimi i grave që punojnë në këtë sektor”, me mbështetjen e Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme dhe Qeverisë së Suedisë. QAGjZh ka ngritur zërin e saj në seancat dëgjimore, aktivitetet publike dhe mediat, me qëllim të ndërgjegjësimit të atyre grave dhe vajzave që punojnë në sektorin e tekstilit dhe këpucëve. QAGjZh ka promovuar gjithashtu respektimin e standardeve ndërkombëtare të punës në këto industri që operojnë prej vitesh në Shqipëri. Kontributi i QAGjZh në temën e të drejtave të grave në punë ka qenë shumë domethënës edhe në veprimet mbikëqyrëse dhe avokuese. QAGjZh gjatë gjithë këtyre viteve ka ndërtuar aleanca, ura komunikimi ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit Kundër Diskriminimit. QAGjZh ka rritur kapacitetet e mbi 2000 grave për të drejtat e tyre në vendin e punës nëpërmjet trajnimeve dhe takimeve, ku u dha një informacion i gjerë mbi legjislacionin shqiptar dhe Kodin e Punës, sigurinë dhe shëndetin në punë. Fushatat ndërgjegjësuese për të drejtat e grave në vendin e punës kanë qenë të shumta gjatë këtyre viteve. Në vitin 2018 u lançua numri i gjelbër pa pagesë 08001818, në mënyrë që gratë dhe vajzat të kenë mundësinë të raportojnë rastet sa

herë që u shkelen të drejtat e punës. Para ndërhyrjeve të QAGjZh, informacioni për të drejtat e grave në këtë sektor ishte disi inekzistent dhe të drejtat e punës shpërfilleshin shumë. Kushtet e punës së grave në disa fabrika ishin katastrofike dhe njohuritë e tyre për të drejtat në vendin e punës ishin pothuajse zero. Në përputhje me misionin e saj, QAGjZh punoi me përkushtim për t'u ofruar grave njohuri mbi të drejtat thelbësore në vendin e punës. Gratë u informuan për rëndësinë e kontratës, orarin e punës, pushimin e paguar dhe lejen e lindjes, shëndetin dhe sigurinë, rolin dhe përgjegjësitë e Këshillit për Shëndet dhe Siguri (KSHS), diskriminimin dhe stresin në vendin e punës si edhe rolin e sindikatave.

Afrimi me gratë punëtore në këtë industri nuk ka qenë një detyrë e lehtë, kryesisht për shkak të mosbesimit të tyre ndaj palëve përkatëse të interesit dhe pafuqisë në lidhje me kushtet e tyre të vështira të punës. Megjithatë, me këmbëngulje të vazhdueshme QAGjZh filloi të fitonte ngadalë besimin e tyre dhe numri i grave që dëshironin t'i bashkoheshin sesioneve informative u rrit. Gratë ishin dhe janë ende të kujdesshme kur marrin pjesë në këto sesione, nga frika se mos ekspozohen nga kolegët e tjerë tek punëdhënësit, por megjithatë shfaqin edhe kuriozitet dhe kanë dëshirë të mësojnë më shumë. Numri pa pagesë i GADC-së 0800 18 18 ndahej gjithmonë me gratë përmes fletushkave, për t'u ofruar atyre një vend të sigurt ku mund të adresonin dhe raportonin shkeljet e të drejtave në vendin e punës në mënyrë anonime, të përfitonin nga ndihma juridike falas në hartimin e padive dhe të tjera çështje të nevojshme në lidhje me plotësim të dokumentacionit, si dhe përfaqësimin në gjykatë. Një nga thirrjet për ndihmë u shndërrua në një histori suksesi, një histori e shndërruar në një artikull, për t'u ndarë me gratë e tjera gjatë aktiviteteve edukative, me synimin për t'i inkurajuar dhe nxitur ato të flasin për të drejtat e tyre.

Disa tema të tjera që u vunë në pah gjatë disa takimeve me gratë ishin ato për shëndetin dhe sigurinë: si nuk i duronin ato aromat e forta; sëmundjet profesionale si dhimbja e kyçeve ose e shpinës për shkak të orëve të gjata në këmbë; kushtet e papërshtatshme të punës, etj. Pas një udhëtimi studimor nga QAGjZh të realizuar në Shtip, Maqedonia e Veriut me Glasen Tekstilec, më 10 qershor 2021, ku një grup grash nga Shqipëria shkëmbyen përvoja me homologe që punojnë në të njëjtin sektor, u diskutua gjatë në lidhje me temën e shëndetit, sigurisë dhe sëmundjet profesionale. Frymëzuar nga bashkëbisedimi i grave, QAGjZh dhe Glasen Tekstilec vendosën së bashku të zhvillojnë një pyetësor me qëllim jo vetëm identifikimin e çështjeve kryesore që lidhen me këtë temë, por edhe për të prodhuar një dokument të përbashkët politikash. Rekomandimet e punimit do të përdoren për veprime avokuese, tryeza të rrumbullakëta me palët e interesuara përkatëse në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe një tryezë rajonale për të tërhequr vëmendjen e aktorëve të ndryshëm dhe për të nisur diskutimin mbi këtë temë.



## Rëndësia e mbrojtjes së shëndetit në punë

Sipas “Parimeve Themelore të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”<sup>1</sup>, botuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Siguria dhe shëndeti në punë (OSH) në përgjithësi përkufizohet si shkenca e parashikimit, njohjes, vlerësimit dhe kontrollit të rreziqeve që lindin në ose nga vendi i punës që mund të dëmtojnë shëndetin dhe mirëqenien e punëtorëve, duke marrë parasysh ndikimin e mundshëm në komunitetet përreth dhe mjedisin e përgjithshëm.<sup>2</sup> Siguria dhe shëndeti në punë janë komponentë jetikë të punës së denjë. Kushtet fizike dhe kërkesat mendore të vendit të punës përcaktojnë në një masë të madhe kushtet e punëtorëve. Aksidentet në punë kanë një kosto të konsiderueshme njerëzore, sociale dhe ekonomike, të cilën ne duhet të përpiqemi ta eliminojmë duke siguruar që të gjitha vendet e punës të jenë të sigurta.<sup>3</sup>

Siç përcaktohet nga Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, substanca të rrezikshme janë çdo lëng, gaz ose material i ngurtë që përbën rrezik për shëndetin ose sigurinë e punëtorëve, të cilat mund të gjenden pothuajse në të gjitha vendet e punës. Në të gjithë Evropën, miliona punëtorë bien në kontakt me agentë kimikë dhe biologjikë që mund t'i dëmtojnë ata. Disa substanca shumë të rrezikshme - të tilla si azbesti ose bifenilët e poliklorinuar (PCB)<sup>4</sup>, tani janë të ndaluara ose nën kontroll të rreptë. Megjithatë, substanca të tjera potencialisht të dëmshme përdoren ende gjerësisht dhe legjislacioni duhet të ekzistojë për të siguruar që rreziqet që lidhen me to të menaxhohen siç duhet dhe dëmi shëndetësor të jetë zero.<sup>5</sup>

Problemet shëndetësore që mund të shkaktohen nga puna me substanca të rrezikshme variojnë nga acarimi i lehtë i syve dhe lëkurës deri te efektet e rënda, si defektet e lindjes dhe kanceri. Efektet mund të jenë akute ose afatgjata, dhe disa substanca mund të kenë një efekt kumulativ. Disa nga rreziqet më të zakonshme janë: alergjitë; sëmundjet e lëkurës; kanceret; probleme me shëndetin riprodhues dhe defektet e lindjes; sëmundjet e frymëmarrjes dhe helmimet.

Disa substanca të rrezikshme paraqesin rreziqe sigurie, si rrezik zjarri, shpërthimi ose mbytjeje. Përveç kësaj, substancat e rrezikshme zakonisht kanë disa nga vetitë e rrezikshme të larpërmendura.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> Alli, B.O. (2008). Occupational Safety and Health. In Fundamental Principles of Occupational Health and Safety, International Labour Office Geneva, [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@dcomm/@publ/documents/publication/wcms\\_093550.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@dcomm/@publ/documents/publication/wcms_093550.pdf) (Last access on January 10<sup>th</sup> 2022, pg.8)

<sup>2</sup> Ibid

<sup>3</sup> <https://ilostat.ilo.org/topics/safety-and-health-at-work/> International Labor Organization website, last visited on March 6, 2022.

<sup>4</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/Polychlorinated\\_biphenyl](https://en.wikipedia.org/wiki/Polychlorinated_biphenyl)

<sup>5</sup> <https://osha.europa.eu/en/themes/dangerous-substances> European Agency for Safety and Health at work webpage, last visited on March 7, 2022.

<sup>6</sup> Ibid





Për të mbrojtur punëtorët nga substancat e rrezikshme, hapi i parë është kryerja e një vlerësimi të rrezikut. Më pas, duhet të ndërmerren veprime për të hequr ose reduktuar sa më shumë që të jetë e mundur rreziqet. Dhe së fundi, situata duhet të monitorohet rregullisht dhe të rishikohet efektiviteti i hapave të ndërmarrë. Punëdhënësit gjithashtu duhet të marrin parasysh çdo grup vulnerabël, siç janë punëtorët që janë të rinj, gratë shtatzëna ose që ushqejnë fëmijën me gji, për të cilat kërkohet mbrojtje e veçantë me ligj. Grupet e tjera të punëtorëve, si punëtorët migrantë, personeli i patrajnuar ose i papërvojë dhe kontraktorët, gjithashtu duhet të merren parasysh, si edhe parandalimi t'u përshtatet nevojave të tyre.

Legjislacioni Evropian për mbrojtjen e punëtorëve vendos një hierarki masash që punëdhënësit duhet të marrin për të kontrolluar rreziqet ndaj punëtorëve nga substancat e rrezikshme. Disa masa që sugjerohen janë:

- Eliminimi dhe zëvendësimi janë në krye të hierarkisë së masave të kontrollit. Kur është e mundur, eliminoni përdorimin e substancave të rrezikshme duke ndryshuar procesin ose produktin në të cilin përdoret substanca.
- Nëse eliminimi nuk është i mundur, zëvendësoni një substancë të rrezikshme me një jo të rrezikshme ose më pak të rrezikshme.
- Nëse një substancë ose proces nuk mund të eliminohet ose zëvendësohet, ekspozimi mund të parandalohet ose zvogëlohet me zgjidhje teknike dhe organizative. Këto janë, për shembull, kontrolli i emetimit në burim (sistemi i mbyllur ose ventilimi lokal i shkarkimit), ose zvogëlimi i numrit të punëtorëve të ekspozuar ndaj substancës së rrezikshme, si dhe kohëzgjatja dhe intensiteti i ekspozimit.
- Sipas ligjit, përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale është zgjidhja e fundit në rastet kur ekspozimi nuk mund të kontrollohet në mënyrë adekuate me mjete të tjera.

Në Shqipëri, gjatë periudhës janar-maj 2020, IP regjistroi 63 kontrole pas aksidenteve në punë, 58 punonjës të lënduar, nga të cilët 12 humbën jetën. Në ndërmarrjet prodhuese në të njëjtën periudhë janë kryer 15 kontrole, 12 punonjës kanë mbetur të lënduar. Të dhënat nga IP tregojnë se<sup>7</sup>:

Janar - Prill 2020	
Nr. total i punonjësve	56242
Nr. i subjekteve që kanë dokumentin e vlerësimit të rrezikut	772
Nr. i subjekteve që kanë këshillin e sigurisë	805
Nr. i subjekteve që kanë përfaqësues nga këshilli i sigurisë	417
Numri i punonjësve të dyshuar për sëmundje profesionale	10
Numri i punonjësve të diagnostikuar me sëmundje profesionale	7
Nr. i subjekteve me shërbim mjekësor	1149
Nr. i subjekteve me kontroll mjekësor periodik të punonjësve	416

<sup>7</sup> <https://rm.coe.int/rap-rcha-alb-12-2021/1680a090e6>

<b>Nr. i punonjësve që punojnë me substanca të rrezikshme</b>	50003
<b>Nr. i subjekteve që kanë masa mbrojtëse kolektive</b>	4984
<b>Nr. i subjekteve që kanë koordinator për sigurinë dhe shëndetin</b>	137
<b>Nr. i subjekteve që kanë shërbimin e ndihmës së parë</b>	884

**Burimi: Inspektoriati Shtetëror I Punës dhe Shërbimeve shoqërore**

Në ditët e sotme, numri i profesioneve dhe disiplinave është jashtëzakonisht i madh, duke e bërë kështu numrin e rreziqeve në vendin e punës shumë të lartë. Në rastin tonë, gratë punëtore në prodhimin e veshjeve dhe këpucëve janë vazhdimisht të ekspozuara ndaj disa kimikateve. Vetë natyra e këtij sektori, i fokusuar në modë, tekstile dhe këpucë, kërkon përdorimin e një numri të konsiderueshëm lëndësh të para të cilat rafinohen dhe prodhohen për të pasur një produkt përfundimtar. Në këtë kuptim, gratë punëtore janë të ekspozuara ndaj dëmtimeve kimike në të gjitha fazat e prodhimit, nga pëlhura te prodhimi i veshjeve/këpucëve.

## **Kuadri Ligjor mbi Sigurinë e Shëndetin në Punë dhe roli i mjekut në ndërmarrje**

Si një kandidat zyrtar për anëtarësim në BE, ligjet dhe nënligjet e brendshme të Shqipërisë janë përafuar me ato të BE-së. Edhe projektligjet e reja të paraqitura në Kuvend, gjatë procesit të shqyrtimit kontrollohen nga Komisioni i Integritimit Evropian në rastet kur kërkohet përshtatje. Në Shqipëri çështja e sigurisë dhe shëndetit në punë rregullohet fillimisht me dispozita kushtetuese dhe më pas me disa akte të tjera. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë u garanton të gjithë qytetarëve të drejtën e mbrojtjes sociale në punë. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë në seksionin VIII "Sigurimi dhe mbrojtja shëndetësore" përcakton detyrimet e punëmarrësve dhe punëdhënësve për sigurinë dhe higjienën në vendin e punës ndaj rreziqeve që rrjedhin nga detyrat e punës. Në shkurt 2004, Shqipëria ratifikoi Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr. 155 "Siguria dhe shëndeti në punë", ku detyrat që rrjedhin nga kjo Konventë u përfshinë në ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 "Siguria dhe shëndeti në punë", i cili është ende në fuqi.<sup>8</sup>

Ligji nr. 10.237, datë 18.02.2010 "Siguria dhe Shëndeti në Punë" si lente të tij mbulon përcaktimet e masave që duhen marrë dhe garantojnë sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë sigurinë dhe shëndetin dhe mbrojtjen e tyre nëpërmjet parandalimit të aksidenteve në punë, eliminimit të rrezikut dhe faktorëve që kontribuojnë në aksidente, informimit, këshillimit në përputhje me ligjin, për të garantuar organizimin e punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre, si dhe krijimi i udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre qëllimeve.

<sup>8</sup> <https://project-balkanosh.net/wp-content/uploads/2019/05/REGIONAL-OSH-STUDY-OF-WESTERN-BALKAN.pdf>



Dokumenti Strategjik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2016 – 2020 synonte të krijonte një fushë të qartë veprimi për aktorët kryesorë në zhvillimin dhe orientimin e ardhshëm të sigurisë dhe shëndetit në punë në Shqipëri. Një nga objektivat ka qenë përmirësimi i numrit të aktorëve të përfshirë në mënyrë aktive në promovimin e shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe forcimi i roleve të tyre. Ekziston një kornizë e përgjithshme e bashkëpunimit, rolet dhe detyrat e vetë Qeverisë, ministrive të caktuara, institucioneve, inspektorateve, partnerëve socialë dhe aktorëve të tjerë. Një pjesë e rëndësishme e këtij dokumenti lidhet me faktin se të gjitha ministritë, qeveria, agjencitë dhe organet e tjera do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe do të bashkërendojnë aktivitetet e tyre të ndërhyrjes.

Tema e Shëndetit dhe Sigurisë në Shqipëri rregullohet edhe nga ligjet dhe Vendimet e Këshillit të Ministratve (VKM) e mëposhtme si:

- VKM nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punonjësit, njerëzit dhe shërbimet e specializuara, që trajtojnë çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë”;
- VKM nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave”;
- VKM nr. 522, datë 6.8.2014, për miratimin e Rregullores “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve nga rreziqet që lidhen me agjentët kimikë në punë”;
- VKM nr. 639, datë 7.9.2016 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe llojeve të analizave të ekzaminimit mjekësor, që do të kryhen në varësi të punës së punonjësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”.
- VKM nr.596 datë 04.09.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 639, datë 07.09.2016 “Për rregullat, procedurat dhe analizat e ekzaminimit shëndetësor, që do të kryhen në varësi të punës së punonjësve, si dhe mënyrës së funksionimit të shërbimit shëndetësor në punë”.

Të gjitha këto dokumente ligjore synojnë të mbrojnë shëndetin dhe sigurinë e çdo punonjësi, pavarësisht se ku ai punon. Përveç kësaj, ato ofrojnë gjithashtu udhëzime për tema të tilla si roli i mjekut, përdorimi i agjentëve kimikë dhe theksojnë përgjegjësinë e palëve përkatëse të interesit.

Neni 23 i ligjit nr. 10 237, datë 18.2.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë” thotë se: “Çdo punëdhënës i një subjekti publik ose privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshme për rreziqet që sjell vendi i punës”.<sup>9</sup> Detyrimet e veçanta të punëdhënësit sanksionojnë përgjegjësinë e tij në kryerjen e vlerësimeve të rreziqeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke përfshirë grupe punonjësish të ekspozuar ndaj rreziqeve specifike, si dhe për përcaktimin e masave/pajisjeve mbrojtëse.<sup>10</sup> Përcaktohen edhe detyrat e punëdhënësit për të garantuar zbatimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, bazuar në ekzaminimin mjekësor, në varësi

<sup>9</sup> <https://www.dpshttr.al/sites/default/files/doenloads/dokumente/Ligji%20Nr.10237%2C%20dat%C3%AB%2018.02.2010%20E2%80%9CP%C3%ABr%20Sigurin%C3%AB%20dhe%20Sh%C3%ABndetin%20n%C3%AB%20Pun%C3%AB%20E2%80%9C.pdf>, (Article 23, pg.14, last access January 17, 2022)

<sup>10</sup> Ibid, Article 9

të vendit të punës.<sup>11</sup> Përmendet edhe marrëdhënia me institucionet përkatëse, për shembull në rastet e detyrimit nga punëdhënësi për të njoftuar dhe deklaruar ngjarje pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës, Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në rastet e aksidenteve me fatalitet, apo ngjarjeve që përbëjnë vepër penale, njoftohet edhe Prokuroria.<sup>12</sup>

Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit dhe detyrave të mjekut. Një sërë nenesh të tjerë të këtij ligji japin përkufizime për termat si mjekësia e punës, mjek i sëmundjeve të punës dhe kriteret që duhet të plotësojnë për të qenë të përshtatshëm për këtë rol. Mjeku i sëmundjeve profesionale, mjeku i familjes ose institucione të tjera shëndetësore publike ose private kanë përgjegjësinë të deklarojnë sëmundjen profesionale të zbuluar gjatë ekzaminimeve mjekësore.<sup>13</sup> Ndryshimet shtesë të këtij ligji në vitin 2015, sanksionojnë rreptësisht që personi i ngarkuar për administrimin e rrezikut shëndetësor në vendin e punës duhet të jetë i kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale dhe i licencuar nga Urdhri i Mjekut të Republikës së Shqipërisë.<sup>14</sup>

*Vendimi nr. 522, për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve nga rreziqet që lidhen me agjentët kimikë në punë" përcakton kërkesat minimale për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve nga rreziqet që janë ose mund të shkaktohet nga efektet e agjentëve kimikë të pranishëm në vendin e punës, ose si rezultat i ndonjë aktiviteti pune që përfshin agjentë kimikë."*<sup>15</sup> Ky vendim përcakton qartë detyrat e mjekut të punës në këtë rast. Kur një punonjës diagnostikohet me një sëmundje të identifikueshme, ose efekt të dëmshëm shëndetësor si rezultat i ekspozimit në punë ndaj një agjenti kimik të rrezikshëm, mjeku informon punonjësin.<sup>16</sup> Këshilla e mjekut për eliminimin ose reduktimin e rrezikut duhet të merret parasysh nga punëdhënësi, duke përfshirë mundësinë e caktimit të punonjësit në një punë alternative, ku nuk ka rrezik për ekspozim të mëtejshëm. Gjithashtu, mjeku i punës propozon që punonjësit e ekspozuar t'i nënshtrohen edhe një ekzaminimi mjekësor.<sup>17</sup>

Siç shihet, të gjitha ligjet, vendimet dhe rregulloret bazohen në qëllimin dhe synimin e përbashkët për të promovuar dhe mbështetur nivelin më të lartë të mirëqenies fizike, mendore dhe sociale të punonjësve. Ata kërkojnë llogari nga disa institucione si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektorati i Punës, Instituti i Shëndetit Publik, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, por edhe punëdhënësit dhe mjekët e punës për t'i dhënë prioritet mbi të gjitha shëndetit dhe sigurisë së punonjësve. Në këto rrethana, mund të thuhet me siguri se boshllëku kryesor mbetet mungesa e vullnetit të mirë dhe profesionalizmit, sesa mungesa e dispozitave ligjore.

---

<sup>11</sup> Ibid, Article 11

<sup>12</sup> Ibid, Article 25

<sup>13</sup> Ibid, Article 25

<sup>14</sup> <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/108.pdf> (Chapter IV, point 7, as amended, pg.5)

<sup>15</sup> <https://www.vendime.al/vendim-nr-522-date-6-8-2014-per-miratimin-e-rregullores-per-mbrojtjen-e-sigurise-dhe-shendetit-te-punemarresve-nga-risqet-e-lidhura-me-agjentet-kimike-ne-pune-3/> (Article 1)

<sup>16</sup> Ibid, Article 10, point 6

<sup>17</sup> Ibid



## Metodologjia

Metodologjia e aplikuar nga QAGjZh gjatë realizimit të pyetësorit konsistonte në një metodë mikse të kërkimit cilësor dhe sasior nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuar, të kryera në një format hibrid. Formulari online google mbledhi 198 pyetësorë, 98 nëpërmjet intervistave telefonike, ndërsa 100 të tjerët u realizuan përmes intervistave ballë për ballë në Tiranë, Bathore, Shkodër dhe Kuçovë.

U zbatuan dy faza, e para u fokusua në mbledhjen e të dhënave të përgjithshme dhe të dhënave për higjienën dhe shëndetin. Pjesa e dytë konsistonte në analizën e të dhënave sipas kategorive përkatëse. Një shfaqje vizuale e informacionit pasqyrohet nga grafikët për të komunikuar në mënyrë efektive interpretimin e të dhënave të mbledhura.

Për të kuptuar më mirë raportin ndërmjet punëtorëve dhe Inspektoratit të Punës, janë realizuar dy intervista me inspektorët e këtij institucioni. Pyetjet e përgjithshme kishin të bënin me frekuencën e inspektimeve, kushtet e punës, inspektimin administrativ të punës së mjekëve, si dhe mënyrën e mbylljes së hendekut mes tyre dhe punonjëseve për sa i përket besimit.


Fjalët kyçe të përdorura ishin: shëndeti dhe siguria, këshilli për shëndetin dhe sigurinë, vlerësimi i faktorëve të rrezikut në vendin e punës, përdorimi i produkteve kimike, lloji i sëmundjes, përdorimi i rrobave dhe pajisjeve mbrojtëse para dhe gjatë COVID-19, trajnim për shëndetin dhe sigurinë, prania e mjekut, niveli i sigurisë në vendin e punës, sugjerimet se çfarë duhet ndryshuar apo përmirësuar.

## Gjetjet kryesore dhe analiza


Në Shqipëri, mbi 95% e punëtorëve të veshjeve dhe këpucëve në fabrikat në Tiranë, Bathore, Shkodër dhe Kuçovë janë gra që punojnë çdo ditë jave dhe shumica e tyre edhe të shtunave, duke zgjatur orët e ekspozimit ndaj kimikateve. Për qëllimin e këtij hulumtimi, QAGjZh lançoi një pyetësor mbi sëmundjet profesionale në vendin e punës me qëllim identifikimin e llojit të kimikateve të përdorura, për të zbuluar nëse gratë pajiseshin me veshje apo pajisje mbrojtëse, prania ose mungesa e mjekëve në fabrikë, si i kryejnë ata detyrat e tyre, vlerësimin e faktorëve të rrezikut për shkak të natyrës së punës, ekzistencën dhe shpeshtësinë e ekzaminimeve të rregullta shëndetësore, etj. Objektivi i përgjithshëm i këtij ushtrimi ishte mbledhja e të dhënave të tilla, analizimi i tyre dhe nxjerrja e rekomandimeve të adresuara për palët e interesuara për të përmirësuar kushtet e punës dhe për të tërhequr vëmendjen shumë të nevojshme në temën e sëmundjeve profesionale.




## Informacion i përgjithshëm mbi grupin e targetuar



Shumica (89%) e grave të intervistuar që punojnë në këtë sektor janë të moshës 26-55 vjeç. Moshë 36 deri në 45 vjeç përbën gati 1/3 e numrit të përgjithshëm të punonjësve që morën pjesë në këtë hulumtim.




Numri i fëmijëve është një faktor i rëndësishëm që përcakton nevojat financiare të grave punonjëse. Të dhënat tregojnë se 91% e kampionit tonë është financiarisht përgjegjës për të paktën 1 fëmijë. Gati gjysma (47%) e grupit të synuar kanë dy fëmijë dhe 20% e tyre kanë tre fëmijë. Gratë që janë nëna të 4 ose më shumë fëmijëve përbëjnë 6% të grupit të synuar. Vetëm 9% nuk kishin fëmijë në momentin kur ishin pjesë e këtij studimi.



Në përgjithësi, gratë që punojnë në fabrikat e veshjeve dhe tekstitil nuk kanë arsimin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale për të bërë punë fizike që janë më pak të vështira. Niveli i ekspozimit ndaj faktorëve të ndryshëm të shëndetit dhe sigurisë pritet të jetë më i lartë tek gratë që kanë punuar për më shumë vite në këtë sektor.

